REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS
MINISTARSTVO ZHIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE
MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE
Njësia org. / Org.Jedinica / Org.Unit: DL
Nr.i Faqeve / Br. Stranica / No.Pages: 02
Nr.i Prot. / Broj Prot. / Prot. No.: 2522-2/22
Data: / Datum: / Date: 12.05.22

PRISHTINË / A
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration
Data / Datum / Date: 12.05.2022
Njësia organizative: -VI- | Nr. i Lendës: 020-180/5

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**
**Qeveria - Vlada – Government**

| | |
|---|---|
| Për: | Ramiz Lladrovci, Kryetar i Komunës së Gllogocit<br>Milaim Hajdari, Kryesuese e Kuvendit të Komunës së Gllogocit |
| Kopje: | Elbert Krasniqi, Ministër i MAPL<br>Venera Çerkini, Zëvendësuese e Sekretarit të Përgjithshëm të MAPL<br>Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL |
| Përmes: | Liburn Aliu, Ministër i MMPHI<br>Izedin Bytyqi, Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI |
| Nga: | Florije Kika, Drejtore e Departamentit Ligjor në MMPHI Date: 04.05.2022 |
| Zyrtarët përgjegjës:<br>1.Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor<br>2.Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor | Sabrije Rama, Udhëheqëse e Divizionit për Mbikëqyrjen e Zbatimit të Legjislacionit, të Mbështetjes Ligjore dhe të Bashkëpunimit Ndërinstitucional në Fushën e Legjislacionit |
| Lënda: | Konfirmohet ligjshmëria e aktit |
| Lloji i aktit: | Vendimi Nr. 02.360-18353 për shfuqizimin e vendimit të Kuvendit të Komunës NR.02-020/04-8424, datë 23.02.2022, miratuar nga KK Gllogoc |

I nderuari Kryetar Lladrovci,
I nderuar Hajdari,

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në pajtim me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (QRK) Nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave më datë 29.04.2022, ka pranuar nga MAPL vendimin Nr. 02.360-18353 për shfuqizimin e vendimit të Kuvendit të Komunës NR.02-020/04-8424, datë 23.02.2022, miratuar nga KK Gllogoc.

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, pas shqyrtimit të ligjshmërisë së aktit në fjalë, dhe në pajtim më Nenin 4 të Rregullores (QRK) Nr. 06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (QRK) Nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, kërkon nga kuvendi i komunës së Gllogocit:

## KONFIRMON

Vendimin Nr. 02.360-18353 për shfuqizimin e vendimit të Kuvendit të Komunës NR.02-020/04-8424, datë 23.02.2022, miratuar nga KK Gllogoc.

## Arsyetimi

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, pas shqyrtimit të përmbajtjes së vendimit Nr. 02.360-18353 për shfuqizimin e vendimit të Kuvendit të Komunës NR.02-020/04-8424, datë 23.02.2022, miratuar nga KK Gllogoc, konstatoi se:

Kuvendi Komunal i Gllogocit, ka vepruar konform vlerësimit të ligjshmërisë së Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturë, Nr.prot.907-2/22, datë 18.03.2022, sipas të cilit Vendimi NR.02-020/04-8424 për formimin e komisionit për çështjen e banimit të përkohshëm social, miratuar nga KK Gllogoc, është vlerësuar se është në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi.

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturë, mbetet në dispozicion të Komunës së Prishtinës dhe MAPL-së, për çfarëdo sqarimi të mëtejmë në lidhje me këtë vlerësim.